

AUTORIZIM
Nr. 7949, datë 3.11.2020

Në mbështetje të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2020, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; vendimit nr. 525, datë 8.8.2007, “Për identifikimin e koncesionit për projektin ‘Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike’”; “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe për një ndryshim në vendimin nr. 196, datë 13.4.2007, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e projektit ‘Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë’ dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Brendshme” dhe kontratës koncesionare, datë 21 korrik 2008, “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike”, të ndryshuar,

AUTORIZOJ:

Znj. Elena Pici, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, të nënshkruajë në emër dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Brendshme, Marrëveshjen “Për hapjen dhe funksionimin e zyrave në ambasada”, me konsorciumin e shoqërive Idemia Identity & Security SA (*Sagem Securite*) dhe Fondit Shqiptaro–Amerikan të Ndërmarrjeve, të përfaqësuara nga shoqëria “Aleat” sh.p.k.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj